



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 29 MAJ 2009

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
29. MAJA 2009. GODINE

MAJ – MAJA
2009

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 29 MAJ 2009

E premte, 29 maj 2009, ora 14:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Mirë se keni ardhur në seancë!

Konstatoj se në sallë janë 68 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Rendin e ditës e keni marrë. Kemi vetëm një pikë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në organizatat e Grupit të Bankës Botërore**

Në pajtim me vendimin e Kuvendit nga seanca e para ditës, komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në organizatat e Grupit të Bankës Botërore dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Para se t'i procedojmë në votimin amendamentet, ftoj Kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Gani Koci, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores të Punës së Kuvendit dhe vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të datës 29 maj 2009, në mbledhjen e mbajtur po me këtë datë, ka shqyrtuar Projektligjin për anëtarësim në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe organizatat e Grupit të Bankës Botërore dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këto rekomandime.

1. Implikimet financiare të Projektligjit për anëtarësim të Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe organizatat e Grupit të Bankës Botërore janë të përballueshme për buxhetin e Republikës së Kosovës.

2. Komisioni i rekomandon Kuvendit të miratojë amendamentet, si në vijim. Nuk dua të përmend tash amendamentet, i kanë të gjithë deputetët përpara, por dua ta shtoj edhe një çështje më tepër për Zyrën e Harmonizimit të Ligjeve atje, që këtij projektligji duhet t'i bashkëngjiten edhe 5 anekse që kanë të bëjnë me Fondin, me rregullat dhe rregullativën e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe organizatat tjera ndërkombëtare. Pra, nuk po i përmend tash edhe marrëveshjet kornizë të këtyre organizatave, që janë dhe duhet të jenë pjesë e këtij projektligji, të cilat Ministria e Ekonomisë dhe Financave i ka proceduar në Kuvend dhe këto do të jenë pjesë e këtij projektligji. Do të thotë, neni 1 në ligj tash bëhet 2 me ndryshimin eventual të amendamenteve. Prandaj, kërkoj që të miratohen këto amendamente dhe të miratohet ligji në tërësi.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Komisionet e tjera, nëse e donë fjalën, nëse jo, atëherë kalojmë të votojmë amendamentet e propozuara. Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për të votuar. Votojmë, tash:

Amendamenti 1

Nuk dua ta përsëris, prej 80-vetave që janë prezent, 67 kanë votuar, nuk ka asnjë “kundër”, mendoj që...

(Ndërhyrje nga salla)

KRYETARI... A i keni kartelat aty? Mirë. E përsërisim edhe njëherë. Me kërkesën tuaj, e përsërisim edhe njëherë votimin për amendamentin numër 1. Deputetët dhe regjia, le të përgatiten për votim.

Votojmë, tash:

A ka pa kartela? Një. Mirë.

Amendamenti 1

Me 78 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr. 1.

Në radhë është amendamenti 2.

Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim. Votojmë, tash:

Amendamenti 2

Me 79 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr. 2.

Amendamenti 3

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Me 79 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr. 3.

Amendamenti 4

Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Me 81 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr. 4.

Amendamenti 5

Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Me 82 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr. 5.

Tani është radha për ta votuar ligjin në tërësi. Ngarkohet Departamenti Ligjor që ta bashkëngjis Aneksin sipas propozimit të Kryetarit të Komisionit, Gani Koci.

Lus regjinë dhe deputetët, të përgatiten për votim. Votojmë, tash:

Konstatohet se me 81 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në organizatat e Grupit të Bankës Botërore. Edhe një herë po e them, me Aneksin që e propozoi deputeti Gani Koci.

Me këtë, kemi përfunduar seancën e sotme. Mirupafshim në seancën e radhës!

Përgatiti.

Njësia e Transkripteve